

Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor, në programet e studimeve me karakter profesional, për vitin akademik 2022 – 2023, duhet të aplikojnë pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse të Universitetit të Arteve nga data **2 Shtator 2022 deri 13 shtator 2022**.

BACHELOR, Viti Akademik 2022-2023 / Kreu IV/1		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/1, pika 1 Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve.	02.09.2022 – 13.09.2022
2.	Kreu IV/1, pika 11 IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar.	17.09.2022
3.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 1 Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën Nr.10. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së si dhe në faqet web përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.8 të këtij udhëzimi.	23.09.2022
4.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 2 IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.	24.09.2022
5.	Kreu IV/1, pika 14 IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar.	27.09.2022
6.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 1 Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit.	07.10.2022 – 11.10.2022
7.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 2 Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar .	18.10.2022
8.	Kreu IV/1, pika 16 IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatë të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditore për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL.	15.12.2022